

# NJOFTIM PUNËSIMI

## SPECIALIST I MARKETINGUT DIGITAL

**ICEBERG**  
COMMUNICATION

Iceberg Communication Shpk është një nga kompanitë lider në Shqipëri që ofron shërbime të plota për klientët e saj në fushën e marketingut, reklamave, marrëdhënieve publike, organizimit të eventeve dhe dekoreve festive, duke rritur me sukses aktivitetin e saj që nga viti 1999 e në vazhdim. Kohët e fundit kompania është duke zgjeruar shërbimet e saj në fushën e marketingut digital duke krijuar më shumë mundësi për klientët e saj dhe për punësimin e profesionistëve të kësaj fushe.

### PËRSHKRIMI I PUNËS DHE DETYRAT

- Studimi i tregut, përcaktimi i tregut dhe klientëve ideal, klasifikimi i klientëve sipas llojit të aktivitetit dhe madhësisë së tyre, përcaktimi i nevojave dhe kërkesave të klientëve potencial.
- Rritja e fluksit të vizitave të klientëve potencial në websitin e kompanisë dhe mediat sociale të saj, mbledhja e informacionit për të dhënat e kontakteve të tyre.
- Komunikimi i personalizuar dhe furnizimi me informacione (content) të nevojshme për klientët në përputhje me fazat e vendimarrjes nga ana e tyre për të blerë shërbimet apo produktet e kompanisë.
- Identifikimi i personave të kontaktit, ndërtimi i marrëdhënieve të shkëlqyera me klientët potencial dhe ata ekzistues, rritja e interesit të tyre për shërbimet dhe produktet e ofruara nga kompania dhe gjenerimi i kërkesave për të blerë nga ana e tyre.
- Rritja e imazhit të brandit dhe ndërgjegjësimi i klientëve potencial për vlerat dhe përfitimet që ata mund të sigurojnë nga shërbimet dhe produktet e kompanisë.
- Analiza e të dhënave, matja e treguesve të performancës për cdo fushatë reklamash dhe kanalet e komunikimit që do të përdoren, si edhe hartimi i propozimeve për përmirësimin e rezultateve në të ardhmen.

### NJOHURITË DHE AFTËSITË E NEVOJSHME

- Të zotërojë njohuri të mira mbi konceptet e marketingut digital dhe të jetë i aftë për zbatimin e strategjive dhe taktikave të marketingut online.
- Të njohë dhe të jetë i aftë të përdorë programet e ndryshme të marketingut të automatizuar, menaxhimit të marrëdhënieve me klientët (CRM) dhe sistemet e menaxhimit dhe publikimit të përmbajtjes së websitit të kompanisë.
- Të krijojë përmbajtje shumë cilësore me informacione, artikuj, guida, infografiks, imazhe, video, etj., në bashkëpunim edhe me stafin krijues të kompanisë lidhur me brandin dhe ti publikojë ato nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit si website, mediat sociale, e-mail, blog, newsletter, etj.
- Të njohë dhe përdor teknikat për optimizimin e motorëve të kërkimit (search engine optimization) në të gjitha përmbajtjet e krijuara me qëllim të ngritjes së nivelit të rënditjes (ranking) të websitit të kompanisë gjatë kërkimit online.
- Të ketë njohuri të mira dhe të përdor në mënyrë efektive taktikat e "inbound marketing" apo "content marketing".
- Të ketë njohuri bazike mbi dizajnin grafik, fotografinë, realizimin e videove, WordPress, HTML/CSS.
- Të ketë aftësinë për të shkruar në mënyrë të shkëlqyer në gjuhën shqipe dhe angleze.
- Të zotërojë aftësi të mira për të punuar në ekip dhe për të komunikuar në mënyrë të përsosur me klientët.



## EDUKIMI DHE EKSPERIENCA

- Të jetë diplomuar në një nga fushat në vijim: Marketing, Menaxhim, Komunikim ose në ndonjë profil të ngjashëm.
- Të ketë një eksperiencë të paktën 1 vjecare në fushën e marketingut digital.

## KUSHTET E PUNËS DHE PAGESA

- Pozicioni i punës është me kohë të plotë.
- Pagesa do të jetë e lidhur me eksperiencën dhe kualifikimin e personit që do të përzgjidhet.
- Mbulohen nga kompania të gjitha sigurimet shoqërore dhe shëndetësore sipas përcaktimeve të legjislacionit shqiptar.
- Kushtet e punës janë shumë të mira.

## DOKUMENTACIONI I KËRKUAR DHE AFATET

- CV dhe letër motivimi
- Diplomat e studimeve bachelor, master.
- Certifikata të trajnimeve
- Të paktën dy referenca nga punëdhënës të mëparshëm, apo nga kolegë dhe bashkëpunëtor.

**Dokumentacioni mund të dërgohet deri ne 30 Qershor 2017, online në [contact@icebergcommunication.com](mailto:contact@icebergcommunication.com) ose në adresën **Rr.Dervish Hima Nd. Ambassador 3, Nr.32, Tiranë.****

**Aplikantët e përzgjedhur do të njoftohen për të zhvilluar një intervistë brenda datës 6 Korrik 2017.**

**Për çdo sqarim mund të kontaktoni në **042267681** ose **0692076769****

